

Pyetësor për të identifikuar shkaktarët e astmës

<i>Ekspozimet ndaj alergjenëve</i>	<i>Përgjigja</i>
A keni simptoma të astmës gjatë të gjithë vitit apo vetëm në kohë të caktuara të vitit?	
A mbani kafshë ose shpendë në shtëpi?	
A rrinë ata më tepër jashtë apo brenda shtëpisë?	
A keni parë buburreca në shtëpi/shkollë/punë muajin e kaluar?	
A keni parë brejtës/minj shtëpi/shkollë/punë muajin e kaluar?	
A ka lagështi, vende të lagura, erë myku, ose myk të dukshëm në shtëpinë tuaj?	
Për pacientët që jetojnë në klimë të thatë, a përdorni një ftohës me avull?	
Këta ftohës a shoqërohen me lagështirë myk/ të shtuar?	
A përkeqësohen simptomat e astmës gjatë sezonit të poleneve ose periudhat më të lagështa të vitit (që çon në më shumë myk dhe këpusha)?	
A keni bërë ndonjëherë testet e alergjisë në lëkurë apo matje të IgE-ve?	
Nëse po, a i keni rezultatet?	
<i>Ekspozimi ngaj irituesve</i>	
A pini cigare?	
Nëse po, sa në ditë dhe prej sa kohësh?	
A pi duhan dikush në shtëpi/punë?	
A konsumoni cannabis (marijuana)?	
A përdorni cigare elektronike?	
A përdorni cigare me avull?	
A përdorni sobë ose oxhak me dru në shtëpi?	
A keni ndonjë ngrohës ose sobë me zjarr pa ventilim në shtëpi?	
A jeni të ekspozuar rregullisht ndaj erërave ose gazrave nga parfumet, agjentët pastrues ose me spraj?	
<i>Puna dhe shkolla</i>	
A kolliteni, a dëgjoni fishkëllima gjatë frymëmarrjes në punë/shkollë?	
A ju nevojitet inhala- tori juaj më shumë gjatë javës në punë/shkollë se sa në fundjavë, larg nga shkolla/puna?	
A ju kruhen apo irritohen sytë ose hunda në punë/shkollë?	
A kanë simptoma të ngjashme kolegët ose studentët e tjerë?	
A jeni të ekspozuar ndaj tymrave, pluhurave, apo avujve në punë?	
Nëse po, cilat janë ato?	
<i>Probleme nazale</i>	
A keni zënie/bllokim të hundëve, rrufë, rrjedhje nga hundët, apo nuhatje të ulur, stinore apo të vazhdueshme?	
Ku janë këto simptoma më keq në shtëpi/shkollë/punë?	
<i>Refluksi gastroezofageal</i>	
A keni urth (një ndjesi djegësire në kraharonin tuaj); a ju kthehet ushqimi në gojë; a ndjeni/ shijoni acid të athët nga stomaku në fytyrë tuaj?	

<i>Medikamente që mund të përkeqësojnë astmën</i>	
A përdorni pika për sytë?	
Nëse po, cilat?	
A përkeqësohen simptomat e astmës pas përdorimit të tyre?	
A përdorni ndonjë medikament që përmban beta bllokues apo inhibitorë të ACE?	
A është përkeqësuar astma juaj që kur keni filluar të përdorni këto medikamente?	
A përdorni aspirina apo antiinflamatorë të tjerë josteroidalë?	
Nëse po, a shfaqen menjëherë simptomat e astmës pas përdorimit të tyre?	
<i>Ndjeshmëri e mundshme ndaj sulfiteve</i>	
A keni fishkëllima, kollë, ose vështirësi në frymëmarrje pasi hani karkaleca, fruta të thata, ose patate të përpunuara, apo pasi keni pirë birrë ose verë? Nëse po, specifikoni ushqimin.	